

Të nderuar pjesëmarrës,

Më 3 maj 1791, 227 vjet më parë, Parlamenti polak “Grand Sejm”-i proklamonte Kushtetutën e dytë më të vjetër në botë, pas asaj amerikane të vitit 1787, Kushtetutën e Polonisë, pasuesen e denjë të Magna Carta-s. Në këtë ditë të madhe për kombin polak, si KLSH promovojmë librin-album “Simbolet polake: 100 vende, figura, ngjarje, arritje të rëndësishme për Poloninë, Europën dhe Botën”, i cili tani vjen i përkthyer i plotë edhe në gjuhën shqipe, nga një grup audituesish të KLSH, në dedikim të Presidentit të institucionit suprem të auditimit të Polonisë (NIK), z. Krzysztof Kwiatkowski, të ish-Presidentit dhe sot Këshilltar i Lartë i NIK, z. Jacek Jezierski, si dhe të Zv-Presidentit të NIK, z. Wojciech Kutyla, për ndihmesën e tyre të spikatur në ngritjen e kapaciteteve audituese të audituesve shqiptarë.

Libri “100 simbolet polake” mbart për lexuesin shqiptar vlera të jashtëzakonshme njohëse të Polonisë, të shpirtit të popullit polak të paepur për liri, të kulturës, artit, traditave, thesareve historike, arkeologjike, ekologjike, ekonomike dhe shkencore të këtij vendi të madh të Evropës dhe botës, mik i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai është një udhëtim në kohë mbi vendet më tërheqëse, doket e një kombi, ngjarjet më epike, krijuesit më përfaqësues dhe personazhet që nuk shlyhen kurrë në kujtesën e tij.

Në një shkrim të botuar në të përditshmen “Ekonomia”, në maj 2013, dedikuar kësaj Dite të madhe për Poloninë, por edhe bashkëpunimit të NIK dhe KLSH, shprehja dëshirën që ky libër “të fliste” shqip. Së bashku me një grup audituesish të KLSH-së, në atë kohë provuam modestisht ta përkthenim.

Në një fjalë kushtuar 100 simboleve të një kombi të madh, është e vështirë t’i sjellësh të gjitha këto ikona të historisë, kulturës, artit dhe ekzistencës së tij. Po përmend disa prej tyre.

Një nga simbolet që më ka tërhequr veçanërisht në këtë libër është Himni kombëtar i Polonisë, i cili quhet “Mazurek Dabrowskiego” (Mazurka e Dabrowskit). Të rrallë janë himnet kombëtare të vendeve të botës, ku shpirti kombëtar shprehet aq mire, sa te himni polak. Ai ka një histori të veçantë. Mazurka është një valle e njohur popullore polake, që shpesh luhet duke u kënduar. Mazurka e Dabrowskit është krijuar si valle e kënduar dy vjet pas ndarjes së tretë të Polonisë mes fuqive të mëdha fqinje me të, ndarje që ndodhi në vitin 1795 dhe e zhdukoi Poloninë përkohësisht nga harta. Mazurka e Dabrowskit u kompozua si himn për legjionin polak, i cili luftonte për Republikën Franceze në Itali. Revolucioni Francez kishte marrë përsipër çlirimin e popujve të shtypur të Europës. Luftëtarët polakë, të mbetur pa shtet, i ishin bashkuar ushtrisë franceze, me shpresën që duke ndihmuar popujt e tjerë të Europës të çliroheshin, këta së bashku do ta ndihmonin popullin polak që të çlirohej dhe të rindërtonte Shtetin e tij.

“Polonia nuk është zhdukur/Polonia nuk ka humbur!”, këndohet në himnin e legjionit polak të Italisë, që, përpara se të bëhej Himni Kombëtar Polak, në shekullin e XX-të, u përhap në trojet e banuara nga polakët, duke kaluar gojë më gojë. Miqtë e mij të Grupit Lab “Çipini”, në këngën e

veçantë kushtuar Polonisë dhe kombit fisnik polak, këndojnë: "E gdhendën hymnin hyjnor/polakët me shpatë në dorë!".

Një tjetër simbol interesant në Librin-album është Lumi Biebrza. Ky është një lumë i çuditshëm, një nga të vetmit lumenj të lënë akoma të lirë në gjendje krejt natyrore në Europën e shekullit të XXI-të, ku lumenjtë janë rregulluar nga dora e njeriut në atë mënyrë sa mund të quhen vepra arti. Lumi Biebrza kalon nëpër një zonë moçalore, e cila është bërë park kombëtar me të njëjtin emër. Ky është një rezervat i natyrës së virgjër, kënetave, me florën dhe faunën e tyre origjinale. Lumi lejohet të dalë nga shtrati dhe të përmbytë zonën moçalore përreth, duke qenë kështu një fenomen natyror i pandikuar nga dora e njeriut, gjë për të cilën është unik dhe interesant. Por lumi Biebrza dhe zona rreth tij nuk duhet të na krijojnë një ide të gabuar për Poloninë. Polakët kujdesen shumë për mjedisin, për tokat dhe lumenjtë e tyre.

Në listën e njëqind simboleve është edhe Zamoshci, i quajtur si një nga shtatë mrekullitë e Polonisë dhe që njihet edhe si qyteti më italian jashtë Italisë. Zamoshci ka shumë ndërtesa me arkitekturën e Rilindjes Italiane, prandaj njihet edhe si "Padova e Veriut". Por e veçanta e Zamoshcit është se ai është ndërtuar në atë mënyrë që ndërtesat e tij të përbëjnë një konfigurim të trupit njerëzor, një simbolikë kjo që ka lidhje me lulëzimin e Humanizmit europian të kohës kur u ndërtua qyteti, në shekullin XVI-të.

Një simbol tjetër-arkeologjia. Polakët janë shumë krenarë për arkeologjinë e tyre, e cila është marrë dhe merret jo vetëm me hapësirën polake por edhe me zona të tjera me interes të madh arkeologjik në botë. Kështu, arkeologjia polake ka tashmë një traditë të madhe në një nga sferat më të rëndësishme të arkeologjisë botërore, në egjiptologji, traditë kjo e themeluar nga arkeologu i nivelit botëror Kazimierz Michalowski. Në këtë pikë, arkeologjia polake është e ngjashme me arkeologjinë e vendeve të mëdha të botës, që e ka sferën e veprimtarisë shumë përtej kufijve të vendit. Arkeologjia polake është shprehje e madhështisë së shpirtit polak. Është tregues i prirjes që kanë polakët për të bërë gjëra më të mëdha se ç' bëjnë zakonisht vendet dhe kombet të krahasueshëm me ta, gjë që është shumë e shëndetshme për kombet, pasi i rrit ata.

Kam parë me shumë kërkues simbolin "Kuajt polako-arabë". Në të gjithë botën e adhurojnë kalin, por në Poloni ka një kult të veçantë për kalin. Këtë e tregon ankandi "Pride of Poland" që mbahet çdo vit në këtë vend, për kuajt e famshëm të racës arabo-polake. Kultu polak për kalin ka një arsye të veçantë, ai është shprehës i shpirtit të lirë polak. Kali që vrapon në fusha është një simbol i shpirtit të lirë njerëzor. Polonia, vendi i fushave të gjera, ku kuajt mund të vrapojnë pafundësisht të lirë, nuk mund të mos e ketë kalin si simbol të veçantë, ashtu si grekët e lashtë kishin kalin Pegasus, simbol të krijimtarisë së lirë të mendjes njerëzore.

Një simbol që të tërheq në Album është Deti Baltik. Duhet ta njohësh historinë e Polonisë për të kuptuar rëndësinë e këtij simboli. Polakët kanë luftuar shumë gjatë historisë së tyre, për t' i penguar ata që donin t'ua mohonin daljen në det. Në asnjë komb tjetër që nuk është ishullor, deti nuk është i ngulitur aq thellë si simbol, sa në mendjen e njeriut polak.

Përmend detin, por nuk mund të anashkalosh Shqiponjën Bishtbardhë Detare, e cila përbën një simbol kombëtar dhe ndodhet edhe në stemën shtetërore zyrtare të Polonisë. Polakët arritën ta mbrojnë këtë specie në zhdukje dhe sot ajo është shtuar mjaftueshëm, sa që mund t'u japin çifte shqiponjash të tilla edhe vendeve të tjera ku kjo specie rrezikohet.

Historia në shqiptarët na ka tërhequr gjithnjë dhe simbolet historike në këtë Libër-Album janë të shumta. Polonia si shtet dhe si komb do të ndahej katër herë, duke u zhdukur nga harta, por do të ringrihej pesë herë shumë fort, për të luajtur gjatë shekujve një rol me rëndësi historike për fatin e Europës dhe të botës.

Në vitin 1683, polakët luajtën një rol vendimtar për shpëtimin e Vienës nga rrethimi i Perandorisë Osmane dhe me këtë, edhe për shpëtimin e të gjithë Europës nga osmanizmi. Në Ushtrinë e Napoleonit, e cila i përhapte idetë përparimtare të Revolucionit Francez në të gjithë Europën, do të kishte më shumë polakë, se nga çdo komb tjetër i Europës. Në vitin 1920, në Betejën e Varshavës, polakët e shpëtuan Europën nga invazioni i Rusisë bolshevike, duke e ndalur Ushtrinë e Kuqe në hyrje të Varshavës. Nëqoftëse nuk do të kishte qenë qëndresa polake dhe Ushtria e Kuqe do të hynte në Gjermani, ku lëvizja komuniste ishte shumë e fortë, e gjithë Europa do të ishte bërë bolshevike, duke përfshirë edhe Francën. Historia e Europës dhe botës do të kishte qenë shumë më e ndryshme nga ç'është sot.

Një simbol tjetër historik është “Beteja e Britanisë”, beteja ajrore që u bë gjatë disa muajve në vitin 1940 mbi qiejt e Anglisë, midis RAF (Forcës Ajrore Britanike) dhe Luftwaffe-s (Forcës ajrore të Gjermanisë naziste). Në kohën kur Britania e Madhe i rezistonte e vetme në Europë agresionit nazist, në anën e britanikëve luftuan edhe disa qindra pilotë polakë, kontributi i të cilëve ishte vendimtar. Kjo pasi Anglisë në atë kohë i mungonin pilotët e sprovuar në luftë me aviacionin nazist, dhe pilotët polakë vinin nga lufta në Poloni e rreth një viti më parë. Ai që njihet si Skuadroni Luftarak Polak u shqua shumë në këtë betejë tremujore. Ndoshta skuadroni luftarak polak do ta meritonte të ishte simbol me vete në Album.

Në vitet 1939-1945, Polonia si shtet dhe si komb kaloi ndoshta periudhën më heroike të ekzistencës së saj, kur zgjodhi më mirë një ndarje të katërt të saj nga fuqitë e mëdha fqinje, se të pranonte ftesën e Hitlerit për një aleancë, në të cilën Polonia joshëj me perspektivën e zgjerimit në lindje, në territorin e Bashkimit Sovjetik. Polonia preferoi që t'i qëndronte besnike aleancës së saj historike me Perëndimin, edhe pse u sakrifikuara për këtë. Sakrifika supreme ishte kryengritja e Varshavës e 1 gusht-2 tetor 1944, e njohur botërisht me termin “Warsaw Uprising”, ku fëmijë, gra, të rritur e të moshuar luftuan me çfarë kishin në dorë për të çliruar qytetin e tyre nga pushtuesit nazistë, por ku, të tradhëtuar nga Ushtria e Kuqe e Stalinit, u masakruan me qindra mijëra vetë.

Një tjetër simbol me vlera të jashtëzakonshme historike është ai që në Album quhet “populli hebre”, që do të thotë “komuniteti hebre” i Polonisë. Në album “Populli hebre” është simboli i fundit, me numrin 100, por jo i fundit për nga rëndësia. Këtë e them, sepse më bënë përshtypje të thella termat në të cilët përshkruhet në Liber ky simbol dhe që sot përbëjnë mendimin që kanë

shumica e polakëve për hebrejtë. Një paragraf i veçuar nga teksti që përshkruan këtë simbol thotë: *“Njëmijë vite bashkëjetese e popullsisë polake dhe hebraike janë shoqëruar me periudha pranimit të ndërsjellta, konflikte të përgjakshme, keqkuptime dhe më vonë periudha të bashkëpunimit harmonik në luftën kundër armikut të përbashkët. Për shumë shekuj mërgimi dhe persekutimi, hebrejtë gjetën strehim në Poloni, madje edhe mbrojtje nga drejtues që iu dhanë atyre privilegje që nuk njiheshin nga vendet e tjera ”*

Në këto rreshta ka një reflektim të sigurt dhe kurajoz për marrëdhëniet polako-hebreje në shekuj. Pavarësisht incidenteve gjatë historisë midis polakëve dhe hebrejve, është fakt se Polonia ka qenë streha më e madhe e hebrejve në botë për mbi njëmijë vjet. Gjysma e diasporës hebreje në botë e ka origjinën nga hebrejtë e Polonisë. Nuk është rastësi që fjala me të cilët hebrejtë e kanë emërtuar Poloninë është “Polin” që do të thotë “Qëndroni këtu”. Polakët krenohen me arritjet e hebrejve me origjinë nga vendi i tyre, siç është nobelisti Isaac Besheviz (shkrimtar), por edhe me burra shteti të shquar izraelitë, siç është David Ben Gurion, kryeministri i parë i shtetit të Izraelit.

Një pjesë e mire e simboleve janë të shumëfishtë. Kështu, në Album ka individë-simbol nga fusha të ndryshme, por ka edhe nga ata që mund t’i quajmë simbole kolektive, si “Virtuozët e muzikës klasike”, “Mjeshttrat e Kinemasë”, “Kompozitorët bashkëkohorë”, “Eksploruesit dhe udhëtuesit”, “Fituesit polakë të çmimeve Oskar”, “Çmimet Nobel të Polonisë”, “Poetët patriotë”, etj. Dhe brenda këtyre emërtimeve do të gjejmë shumë emra, shpesh të njerëzve mjaft të njohur në botë, nga të cilët e ke të vështirë të përzgjedhësh, për t’i përmendur.

Megjithatë, disa janë radhitur individualisht në njëqind simbolet, të përmendur me emrin e tyre, si Frederik Chopin, kompozitori i madh, i cili e bëri mazurkan polake të njohur botërisht, Papa Gjon Pali II, Lech Walesa, Ryszard Kapuscinski, shkrimtari dhe studjuesi i njohur, Mikollaj Kopernjik, astronomi i famshëm që frymëzoi Giordano Brunon dhe Galileo Galilein, shkencëtarja e mirënjohur, nobelistja Maria Sklodowska-Curie. Renditet individualisht ndër njëqind simbolet edhe astronomi i famshëm polak, i cili eci në gjurmët e Kopernjikut, Aleksandër Wolszczan, zbuluesi i të parit planet jashtë sistemit tonë diellor.

Gjithashtu, në listën e njëqind simboleve përmendet individualisht edhe Ignacy Lukasiewicz, gjeniu me emrin e të cilit lidhet hapja e pusit të parë të naftës në botë, ndërtimi i rafinerisë së parë të naftës, si dhe përdorimi për herë të parë i vajgurit për ndriçim.

Ndërsa në nënlistën e individëve-simbole është edhe Jan Matejko piktori i madh polak i temave historike, shprehës i shpirtit polak. Janë përzgjedhur për t’u përmendur individualisht edhe dy personalitete të Revolucionit Amerikan, me origjinë polake, Tadeusz Kosciuszko dhe Kazimierz Pulaski. Polonia ka dhënë kontributin e saj në shumë ngjarje të mëdha botërore, si Revolucionin Amerikan, Revolucionin Francez, etj.

Ky vend ka aq shumë shkrimtarë, poetë dhe shkencëtarë të njohur botërisht, sa vetëm me ta mund të bëhej një album me njëqind simbole. Kështu që kuptohet se sa e vështirë ka qenë detyra

e autorëve të këtij Libri-Album, për të përzgjedhur në plejadën e njerëzve të shquar të vendit të tyre në gjithë këto fusha.

Në Album, ndër njëqind simbolet polake paraqiten dhe Opera Polake, Teatri Polak, por edhe folklori polak. Polakët janë ndjekës të mëdhenj të operës dhe teatrit dhe Shteti atje kujdeset shumë për to. Por polakët janë shumë krenarë edhe për folklorin e tyre dhe traditat e tjera artistike.

Në Album paraqitet si simbol kombëtar edhe monedha polake, zloty. Polakët janë shumë krenarë për monedhën e tyre dhe çdonjëri e ndjen detyrë të kontribuojë për fuqizimin e saj. Ne vitin 2010, në kulmin e krizës botërore ekonomike dhe financiare 2008-2012, Polonia ishte i vetmi ndër shtetet e zhvilluara evropiane, që shënonte një rritje pozitive ekonomike. Çdo polak nuk i lejon vetes që të bëjë tregti apo çfarëdo transaksioni financiar në monedhë të huaj, kur është e mundur që të përdorë monedhën e tij kombëtare. Zloty sot është një monedhë solide, me emër të mirë në rrethet financiare ndërkombëtare. Polonia ka sot një ekonomi në rritje dhe Zloty-n kaq të fortë, sa polakët mendohen dy herë para se të kërkojnë të anëtarësohen në Eurozonë, duke pasur parasysh problemet e saj me stanjacionin në vitet e fundit. Sot Polonia është faktikisht një fuqi e madhe evropiane, vendi i pestë në Evropë për fuqinë ekonomike, si dhe një shtyllë e rëndësishme e NATO-s në Europën Lindore.

Ky shtet është një vend mik i Shqipërisë dhe këtë e ka treguar me prova. Për të gjitha marrëveshjet për integrimin e Shqipërisë në strukturat euroatlantike, të cilat kanë pasur nevojë për ratifikim nga parlamentet e vendeve anëtare, Polonia ka qenë gjithmonë në grupin e parë të vendeve që i ka ratifikuar.

NIK-u polak, një ndër institucionet supreme të auditimit(SAI-t) ndër më të mëdhatë në Evropë (me mbi 1700 auditues), është një nga SAI-t më aktivë në arenën ndërkombëtare, duke zgjeruar njohuritë e tij të standardeve të auditimit dhe praktikat e mira, si dhe duke ndarë përvojën dhe arritjet me SAI të shumtë partnerë, ndër të cilët është dhe KLSH. NIK bashkëpunon intensivisht në kuadër të EUROSAT -t Audituesit e tij kanë ndihmuar audituesit e Gjykatës Evropiane të Audituesve në misionet e tyre të auditimit të kryera në Poloni dhe kudo në vendet e Bashkimit Evropian. Që nga viti 2010, NIK ka qenë SAI kryesues i Nënkomitetit të INTOSAI-t për Standardet e Auditimit të Brendshëm. Në vitin 2012, NIK u emërua auditues i jashtëm i Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN).

Me ish-Presidentin e NIK, z. Jacek Jezierski, në korrik 2012 nisëm bashkëpunimin intensiv me trajnime dhe vizita studimore të audituesve shqiptarë në Poloni, ndërsa me Presidentin aktual, z. Krzysztof Kwiatowski, në mars të vitit 2016 në Varshavë nënshkruam deklaratën e përbashkët, ku si institucione të auditimit suprem angazhoheshim për arritjen e objektivave të Projektit të Binjakëzimit IPA 2013 të Bashkimit Evropian për Rritjen e Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm Publik në Shqipëri, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së dhe standardet e aplikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI). Të dy SAI-t, ai polak dhe shqiptar, punuan ngushtësisht së bashku për arritjen e rezultateve të aktiviteteve të projektit. NIK solli ekspertët e tij më të mirë për të trajnuar audituesit shqiptarë në fushat e

auditimeve të performancës, financiare, të përputhshmërisë, të teknologjisë së informacionit, etj. Ky projekt(mars 2016 e që po vijon deri në qershor 2018) ishte dhe është i një rëndësie të madhe për Kontrollin e Lartë të Shtetit, pasi institucioni dhe audituesit patën mundësinë të njihen me praktikat më të mira në fushën e auditimit dhe trajnimet që u kryhen gjatë ë projektit i shërbyen ngritjes së tyre profesionale dhe modernizimit të KLSH.

Mikpritja polake renditet si një nga njëqind simbolet kombëtare. Ajo është e jashtëzakonshme dhe ngjan shume me mikpritjen shqiptare.

Po e mbyll këtë vlerësim modest të këtij Libri-Album të jashtëzakonshëm “100 Simbolet Polake”, me një konsideratë. Rreth 40 simbole të Librit janë shumë të përfunduar me simbole të historisë, kulturës, arteve, traditave dhe natyrës së kombit shqiptar. Polakët dhe shqiptarët i bashkojnë sakrificat e panumurta në luftën dhe etjen e tyre të pashuar për liri, jetesë në Familjen e Madhe Evropiane, me dinjitet dhe krenari për origjinën dhe zakonet e tyre. Për krenarinë dhe dijet e brezave të rinj që vijnë, por edhe për të huajtë që na vizitojnë përherë e më shumë, do të ishte me vlerë të kishim edhe ne një Album të ngjashëm me njëqind simbole shqiptare, të shoqëruar me një tekst që i shpjegon kaq thjesht, shkurt dhe bukur ato, sa teksti i Librit-Album polak. Nëse ndërkohë, ndonjë institucion shqiptar nuk do ta ndër marrë këtë nismë, pasi të largohem nga detyra e Kryetarit të KLSH, mendoj t’ia përkushtoj një pjesë të kohës dhe përpjekjeve të mija përgatitjes së librit-album të 100 Simboleve Shqiptare.